



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2588/4 Prot.

Tiranë, më 28.10 2025

V E N D I M

Nr. 142 dt. 28.10 2025

“PËR
MIRATIMIN E DRAFT DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË SIGURISË SË
INFORMACIONIT NË UST SI DHE DRAFT RREGULLORES SË SISTEMIT
PITAGORA”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4, gërma a, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7 paragrafi 4 gërma a dhe 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Urdhërit të brendshëm nr. 22, datë 03.09.2025 “Për hartimin e draft dokumentit të politikave të sigurisë së informacionit në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, shkresën nr.2424 prot., datë 10.10.2025 “Relacion mbi hartimin e draft rregullores “sistemi Pitagora në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, përgatitur nga grupi i punës për hartimin e draft rregullores, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e draft dokumentit të Politikave të Sigurisë së Informacionit në UST si dhe draft Rregullores së Sistemit Pitagora” (bashkëlidhur vendimit);
2. Ky Vendim i përcillet të gjitha njësive përbërëse të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

